



Planuar / Doretuar Priljeno/Prodato Received / Delivered	11.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedintca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHUK	1304/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.125/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, bazuar në Aktgjykimin me numër A.nr.2676/19 të datës 02.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.437/2019 të datës 31.07.2019, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted]

Prishtinë, kundër organit të punësimit Policia e Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës-avncim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.437/2019 e datës 31.07.2019, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] nëpunëse civile në Policinë e Kosovës, më datë 31.07.2019 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 3385/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.237-KA-2019 të datës 18.07.2019 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes së të drejtës së punës (trajtim i pabarabartë), aktit administrativ (vendim adekuat i munguar) dhe diskriminimit në pagë.

Bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.08.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës, ndërsa më datë 09.08.2019, Këshilli ka pranuar dokumentacionin me provat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 4859/2019 të datës 16.10.2019, ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës

numër A.nr.437/2019 të datës 31.07.2019, duke e udhëzuar të njëjten për të drejtën e inicimit të padisë në gjykatën kompetent në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative me datën 02.12.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2676/19, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses, duke anuluar njoftimin e datës 16.10.2019 të KPMSHCK-së dhe ka obliguar të njëjtin që në afat prej tridhjetë(30) ditësh, të vendos lidhur me ankesën e ankueses me numër A.nr.437/2019 të datës 31.07.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3397/2019 të datës 01.08.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër 237-KA-2019 të datës 18.07.2019 të Komisionit për Ankesa në Policinë e Kosovës; Përgjigjen e datës 30.01.2012 nga Policia e Kosovës; Kërkesën për sqarim të datës 20.12.2011 nga Policia e Kosovës; Përgjigjen e datës 08.02.2012 nga Policia e Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 03.02.2012; E-mailin zyrtar të datës 01.02.2012; E-mailat zyrtar të datës 30.01.2014; E-mailin zyrtar të datës 28.01.2014; E-mailin zyrtar të datës 22.01.2014; E-mailin zyrtar të datës 23.03.2015; E-mailin zyrtar të datës 01.04.2015; E-mailin zyrtar të datës 01.04.2015; E-mailin zyrtar të datës 31.03.2015; Shkresën zyrtare të datës 02.06.2015 lidhur me mos pajtimin me kategorizimin dhe përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi për stafin civil; Ankesën e ankueses të datës 21.06.2019 për Komisionin e Ankesave në Policinë e Kosovës; Formularin e PDP për përshkrimin e detyrave të punës për titullin e punës zyrtar administrativ; Kërkesën e datës 23.12.2013 për rishqyrtimin e vendimeve për zyrtarët e administratës së DSORVP-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.08.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 09.08.2019 nga Policia e Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Shkresën zyrtare të datës 20.03.2006 lidhur me Vendimin për caktim të ankueses në Policinë e Kosovës; Njoftimin e datës 17.03.2006 mbi punësimin e personelit civil të SHPK-së ; Kontratën e marrëdhënies së punës së ankueses e datës 20.03.2006; E-mailin zyrtar të datës 17.07.2019; E-mailin zyrtar të datës 19.06.2019; E-mailin zyrtar të datës 29.05.2019; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të ankueses e datës 11.09.2015; Kërkesën e datës 10.03.2022 për prova shtesë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 10.03.2022 nga Policia e Kosovës lidhur me provat shtesë; Propozimet fillestare nga Policia e Kosovës lidhur me titullin e vendit të punës për ankuesen; Aprovimet nga MAP-MF lidhur me titujt e vendeve të punës, gradat dhe koeficientin e gradave; E-mailin zyrtar të datës 30.11.2017 për klasifikimin e vendeve të punës për Policinë e Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 01.03.2017 për klasifikimin e vendeve të punës për Policinë e Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 01.12.2016 për klasifikimin e vendeve të punës për Policinë e Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 11.10.2016; E-mailin zyrtar të datës 30.11.2017; E-mailin zyrtar të datës 27.03.2017 lidhur me klasifikimin e Policisë së Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 22.03.2017 për klasifikimin e Policisë; E-mailin zyrtar të datës 21.03.2017 për klasifikimin e Policisë; E-mailat zyrtar të datës 20.03.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Sipas provave të lëndës respektivisht Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar të datës 20.03.2006 dhe Kontratës së Punës se datës 11.09.2015, rezulton se ankuesja është e punësuar në Policinë e



Kosovës në pozitën "Nëpunëse", në kuadër të Njesisë së Zyrës së Operatives dhe Resurseve-Drejtoria për Sigurimin e Objekteve me Rëndësi të Veçantë dhe Personaliteteve. E njëjta disa herë radhazi i është drejtuar organit të punësimit me kërkesë për avancim, ndërsa bazuar në shkresat e lëndës Kolegji gjen se në përgjigje të kërkesës së ankueses, organi i punësimit ka njoftuar të njëjtën se realizon koeficientin e pagës së nëpunëses, pasi që ankuesja sipas Kontratës së Punës mban pozitën e nëpunëses.

Ankuesja më datë 21.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovë, lidhur me atë së të gjithë punonjësit e kategorizuar në pozitat nëpunës janë sistemuar në pozita zyrtar ose zyrtar personeli përveç ankueses dhe një nëpunëses tjetër dhe kërkon që e njëjta të kategorizohet në pozitën si zyrtare e jo si nëpunëse.

Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës, me datë 18.07.2019 ka nxjerrë vendimin me numër 237-KA-2019, sipas të cilit e ka hedhur poshtë ankesën e ankueses si të jashtë afatshme duke e lidhur afatshmërinë e ankesës më Vendimin për sistemimin e ankueses me reference KPS-DP-AP/2591 të datës 20.03.2006. Ankuesja e pakënaqur me këtë vendim më datë 31.07.2019, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes së të drejtës së punës (trajtim i pabarabartë), aktit administrativ (vendim adekuat i munguar) dhe diskriminimit në pagë, e njëjta kërkon që ti aprovohet ankesa si e bazuar, kërkon nga Këshilli t'a obligoj Policinë e Kosovës që të nxjerrë vendim adekuat lidhur me statusin e saj si dhe të bëjë kompensimin në pagë si e dëmtuar deri tani për shkak të mos marrjes së këtij vendimi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenit 3 paragrafi 1 ku është përcaktuar se: "1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil", si dhe nenit 9 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin është përcaktuar se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara me aktin e kantatës së punës", dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësi civil gëzon të drejtën e realizimit të pagës të përcaktuar në aktin e themelimit të marrëdhënies së punës. Në kuptim të kësaj baze ligjore dhe duke marrë parasysh shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar të datës 11.09.2015 ushtron detyrën e nëpunëses dhe se njëjta realizon pagën në vlerën e përcaktuar me kontratë respektivisht në vlerë prej 291.36 Euro.

Po ashtu, në kuptim të qëndrueshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka analizuar nenin 7 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, me të cilin përcaktohet se: "Udhëheqësit e institucioneve të administratës publike i'a propozojnë gradat e pozitave në institucionin e tyre ministrisë përgjegjëse për administratë publike, në bazë të rekomandimeve të personit përgjegjës për burime njerëzore në institucionin e tyre, i cili është përgjegjës për zbatimin e standardeve dhe procedurave për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. 2. Grada për secilin pozicion të punës dhe ndryshimet, miratohen nga Qeveria me propozim të institucionit përkatës dhe aprovimit paraprak të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrive përgjegjëse për financat", rrjedhimisht Kolegji në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në nenin 26 dhe 27 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës konstaton se, avancimi në pozitë mund të bëhet vetëm nëpërmjet zhvillimit të procedurave ligjore të avancimit gjegjësisht avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: "1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimin të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit,

dëshimit të meritës, aftësi dhe kompetencës profesionale". Andaj, mbi këto arsye ligjore Kolegji konstaton se sistemimi i ankueses nga pozita e nëpunëses në pozitën e Zyrtarit, mund të behët vetëm përmes procedurës së avancimit të përshkruar si më lartë, e në këtë kuptim Kolegji vlerëson se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Përkitazi me pretendimin ankimor së të gjithë punonjësit të kategorizuar në pozitën nëpunës janë sistemuar në pozita zyrtar ose zyrtar personeli përveç ankueses, Kolegji nga analizimi i provave të lëndës nuk ka gjetur dëshmi nga e cila mund të provohet një fakt i tillë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se institucionet e administratës publike në funksion të veprimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre, duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për sistemimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në kuadër të institucionit duke marrë parasysh përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës së nëpunësve civil.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.125/2022

Ardita Perçuku-SHYTI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Znj. *Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;*
- Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

